

Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

RAPORT MUJOR

i Projektit të USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim

nëntor 2016

I. AKTIVITETE TË ZBATUARA

Komponenti 1 - Informimi i opinionit dhe bashkësive

- **Prezantime publike të punëtorive kreative.** Shkollat të cilat morën pjesë dhe ishin pjesë e punëtorive kreative dhe metodologjisë së forumit teatral i prezantuan produktet finale të punëtorive kreative. U mbajtën tre prezantime publike në SHM “Moshja Pijade”, komuna e Tetovës, SHM “Naum Naumovski Borçe”, komuna e Krushevës dhe SHM “Kosta Susinov”, komuna e Radovishit, në të cilat morën pjesë mbi 400 mysafirë. Atmosferën prej ngjarjeve mund ta shikoni në publikimet në ueb faqe dhe në faqen e fejsbukut të PINA – *Integratika*.
- **Forume teatrale.** U mbajtën 3 forume teatrale në SHM “Moshja Pijade” Tetovë, SHM “Naum Naumovski Borçe”, Krushevë dhe SHM “Kosta Susinov” Radovish. Në forumet teatrale morën pjesë mbi 300 pjesëmarrës, mësimdhënës si dhe mysafirë të tjerë të bashkësive lokale të cilët patën mundësi që në mënyrë aktive t’i ndajnë qëndrimet, të bashkëpunojnë dhe të gjejnë zgjidhje potenciale në skenën e vendosur, me qëllim të thyerjes graduale të stereotipeve dhe paragjykimeve për përforsimin e bashkëpunimit ndëretnik.
- **Pjesëmarrje.** Në programin e mëngjesit në RTVM morën pjesë pjeëmarrës të PINAs të akademisë debatuese, me qëllim që të ndahen me opinionin përvojat dhe praktikat pozitive në drejtim të integrimit ndëretnik në kuadër të akademisë debatuese. Gjithashtu, në programin e mëngjesit në TV Tellma ishin mysafirë mësimdhënësit-mentorë dhe një nxënëse e SHM “Koço Racin”, komuna Shën Nikollë të cilët u përfshinë në procesin e punëtorive kreative dhe forumit teatral. Shtesë, prezantimet publike të punëtorive kreative dhe forumeve teatrale janë mbuluar prej mediave nacionale dhe lokale dhe prej mediave të shtypit.
- **Video.** U përgatit dhe u publikua video për akademinë debatuese në të cilën morën pjesë 120 pjesëmarrës të shkollave të mesme të Maqedonisë. Shtesë, në vijim është incizimi i videos e cila e prezanton miqësinë e suksesshme të dy nxënësive me përkatësi të ndryshme etnike të SHF “Liria”, komuna e Tetovës, e cila ka dalë si rezultat i pjesëmarrjes së tyre në aktivitete të cilat u zbatuan në kuadër të PINA-s.
- **Përgatitje për ngjarje solemne të prerjes së shiritit.** Në mënyrë të detajuar planifikohen dhe përgatitën ngjarjet solemne të radhës për prerjen e shiritit në shkolla, qëllimi i së cilave ishte të shënohet përfundimi i suksesshëm i rinovimit të shkollave. U përgatitën skenarët për këto ngjarje dhe në vijim janë përgatitjet e aktiviteteve të cilat i zbatojnë shkollat në drejtim të zhvillimit të integrimit ndëretnik, ndërsa do të prezantohen në ngjarjet solemne para mysafirëve dhe bashkësitë lokale.
- **Informim i rregullt i institucioneve, komunave dhe shkollave për aktivitetet e PINA.** Një pjesë e aktiviteteve kanë përfshirë edhe azhurnimin e rregullt të informacioneve dhe publikimin e risive dhe tregimeve për rrjedhën e aktiviteteve në faqen e facebook-ut *Integratika*, si dhe në ueb faqen e projektit www.pmio.mk. Gjithashtu, aktivitetet të cilat u zhvilluan në kuadër të shkollave (të pavarura apo në partneritet me shkollat e tjera), gjatë asaj periudhe kishin mbështetje dhe mbulim medial. U përgatit edhe informatori medial dhe u nda me të gjitha shtëpitë mediale në vend.

Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorive të shkollave dhe arsimtarëve

- **Regullimi administrativ dhe financiar i procedurës për pagesën e granteve për involvimin e prindërve.** Vazhdoi sigurimi i mbështetjes së shkollave të cilat ishin pjesë e grant programit për involvimin e prindërve me përgatitjen e dokumenteve administrative dhe financiare për pagesën e granteve prej aktiviteteve të realizuara për INA.
- **Trajnim për studentët e fakulteteve pedagogjike.** Një grup prej 20 studentësh të fakulteteve pedagogjike në Republikën e Maqedonisë morën pjesë në trajnimin në Ohër me qëllim që mësimdhënësit e ardhshëm të sensibilizohen për punën e zhvillimit të integrimit ndëretnik përmes procesit arsimor.
- **Pjesëmarrje në organizimin dhe realizimin e Punëtorisë për finalizimin e procedurës për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave për aktivitetet e INA.** Në punëtorinë dyditore, të organizuar me mbështetjen e OSBE-së ndërsa me pjesëmarrjen e grupit punues për INA në kuadër të MASH-it u prezantuan rezultatet e hulumtimit elektronik për INA në vitin 2016. Gjithashtu u rezyman dhe u dakorduan aktivitetet e ardhshme të grupit punues për INA.
- **Takim me koordinatore dhe drejtorë të SIT të shkollave në Komunën e Tetovës.** I organizuar nga anëtarë i Komisionit për INA në kuadër të Komunës së Tetovës (komision për bashkëpunim të thelluar për INA) u mbajt takim me koordinatore dhe drejtorë të SIT të shkollave në Komunën e Tetovës në të cilën i ndanë arritjet e deritanishme në INA, planifikimet për aktivitetet e ardhshme të INA dhe morën sugjerime për arritje të mëtejme në INA.
- **Punëtori me temë „Çarshia e vjetër: thesar kulturash”.** Në Manastir u organizua punëtori dyditore në të cilën mori pjesë një grup prej 30 nxënësve të bashkësive të ndryshme etnike (romë, shqiptarë, maqedonas), prej dy shkollave të Shkupit dhe dy prej Manastirit. Qëllimi i punëtorisë ishte përmes projekteve të përbashkëta të mësojnë të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë vlera për integrimin ndëretnik.
- **Përgatitje e punëtorisë „Ditët e integrimit ndëretnik”.** U përgatit koncepti për punëtorinë në të cilën morrën pjesë përfaqësues nga të gjitha shkollat e 6 komunave të përzgjedhura (Butel, Kumanovë, Bërvenicë, Gostivar, Kërçovë dhe Strumicë) në të cilat u mbajtën Ditët e integrimit ndëretnik. Qëllimi i punëtorisë është të bëhet reflektim – këmbim i përvojave pozitive prej realizimit të aktiviteteve të përbashkëta të ngjarjeve përfundimtare në të gjitha 6 komunat dhe të nxiten aktivitete për qëndrueshmërinë e së njëjtave.
- **Distribrimi i Doracakut „40 aktivitete sportive dhe lojëra argëtuese për integrimin e fëmijëve dhe të rinjve”.** U bë distribrimi i Doracakut “40 aktivitete sportive dhe lojëra argëtuese për integrimin e fëmijëve dhe të rinjve” në të gjitha shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë.

Komponenti 3 – Shkolla modele

- **Shfaqje.** Nga fundi i muajit në SHF “Bratstvo Edinstvo”, komuna e Ohrit u mbajt shfaqje me rastin e Ditës së alfabetit të gjuhës shqipe. Shfaqja u realizua me pika multikulturore dhe të integruara me nxënës të gjuhëve mësimore të ndryshme.
- **Doracaku për participimin demokratik.** Përgatitjet finale për shtypjen e doracakut për participimin demokratik të nxënësve në shkollë në të gjitha gjuhët mësimore u finalizua. Doracaku do të shtypet në muajin në rradhë, dhe pastaj do të distribuohet në të gjitha shkollat në vend.
- **Participimi demokratik.** Gjatë muajit në të gjitha shkollat modele përfundoi procesi i përzgjedhjes së Kryesisë së Bashkësisë shkollore.

Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

Komponenti 4 - Nxitja e shkollave

- **Kontroll teknik.** Në një shkollë përfunduar aktivitetet për rinovim të cilat ishin obligim i PINA. Kontrolli teknik i aktiviteteve përfundimtare u organizua në SHM “Mosha Pijade”, komuna e Tetovës.
- **Sesione të mentorëve.** Pas mbajtjes së trajnimit për përforcimin e kapaciteteve të personelit teknik dhe sekretarëve për mirëmbajtjen e shkollave, janë organizuar 15 sesione të mentorëve në të gjitha shkollat e rinovuara në vitin 2016. Në këto sesione të mentorëve personat profesional të sferave të makinerisë dhe ndërtimitarisë u ndihmuan sekretarëve dhe personelit teknik të shkollave që më mirë të ballafaqohen me problemet lidhur me mirëmbajtjen e shkollave.
- **Marrëveshje për donacion.** Janë përgatitur dokumentet dhe janë nënshkruar marrëveshje për donacion me tetë shkolla të rinovuara.

Monitorimi dhe vlerësimi

- **Aktivitete për monitorim dhe vlerësim.** Monitorimi i aktiviteteve vijuese të PINA.
- **Hulumtimi elektronik.** Prezantimi i rezultateve të hulumtimit elektronik gjatë Grupit punues të PINA-s pranë MASH-it. Realizimi i punëtorisë për analizimin, interpretimin e të dhënave të hulumtimit elektronik për Grupin punues të PINA-s pranë MASH-it.

Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

II. AKTIVITET VIJUESE PËR MUAJIN E ARDHSHËM

Komponenti 1 – Informimi i opinionit dhe bashkësive

- Organizimi dhe mbajtja e dy ngjarjeve solemne e prerjes së shiritit në dy shkolla fillore të rinovuara në komunën e Krushevës dhe komunën e Mogillës.
- Azhurnim i rregullt i informacioneve dhe publikimi i risive dhe rrëfimeve gjatë aktiviteteve përmes faqes së Facebook-ut Integratika dhe ueb – faqes së projektit www.pmio.mk.

Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorive të shkollave dhe arsimtarëve

- Vazhdimi me realizimin e takimeve të mentorëve me SIT-ët me pjesëmarrjen e shkollave të cilat nuk morën pjesë në ciklin e kaluar të takimeve të mentorëve.
- Rregullimi grafik i Doracakut për këshillat shkollorë në gjuhën shqipe dhe publikimi i Doracakut në ueb faqen e PINA dhe MASH.
- Rezultate të analizës së të dhënave të marra prej vlerësimit të pjesëmarrësve në aktivitetet me pjesëmarrjen e prindërve në INA.
- Mbajtja e punëtorisë për refleksion dhe qëndrueshmëri me mësimdhënësit – realizatorë në Ditët për INA.
- Vizitë e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve në shkollat e tre komunave për bashkëpunim të thelluar – Tetovë, Radovish dhe Shtip.

Komponenti 3 – Shkolla modele

- Shtypja e doracakëve për Partecipimin demokratik.
- Shtypja dhe distribuimi i certifikatave për aktivitetet e INA-s.
- Mbajtja e prezantimeve shkollore për leksionet e mësuara të rezultatet e arritura në të gjitha Shkollat modele.

Komponenti 4 - Nxitja e shkollave

- Aktivitete për rinovim dhe kontroll teknik i objektit të rinovuar shkollor në ShFM “Lazo Micev Rale”, komuna e Kavadarit pas përfundimit të aktiviteteve ndërtimore.
- Përgatitja e certifikatave për pjesëmarrje në trajnime për mirëmbajtjen e objekteve shkollore për anëtarët e ERSH dhe personelit teknik të 63 shkollave të rinovuara.

Monitorimi dhe vlerësimi

- Përgatitja e raportit final për Monitorim dhe vlerësim.
- Aktivitete me grupin punues të MASH.